



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 2683 prot.

Tiranë, më 04 / 10 / 2019

URDHËR

Nr. 95, datë 04.10.2019

PËR  
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË DHE  
DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË DORËZONJË KANDIDATËT PËR ANËTAR  
TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT  
AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË


Në bazë të nenit 39, 46 e vijues ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 28, 29, 32, 33 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së nxjerrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Senatit Akademik nr. 56, datë 27.09.2019 “Për nisjen e procedurave për krijimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT”,

URDHËROJ:

1. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT, janë si më poshtë:
  - a) Të jetë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
  - b) Të mbajë titullin akademik “Profesor”.
  - c) Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal.
  - d) Të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.
  - e) Të mos jetë marrë masë disiplinore ndaj tij.
  - f) Të mos ketë shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar dhe ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
  - g) Të mos jetë anëtar në më shumë se 2 (dy) komisione të përhershme.
2. Dokumentacioni që duhet të dorëzojë për aplikim kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT, është si më poshtë:

- a) Kopje e dokumentit të Identifikimit ID/ Pasaportë.
  - b) Kopje të njësuar me origjinalin të diplomës/dëshmisë së titullit akademik “Profesor” ose vërtetim të lëshuar nga UMT-ja në mungesë të diplomës/dëshmisë.
  - c) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
  - d) Vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore.
  - e) Vetëdeklarim se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit..” i ndryshuar, dhe ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, si dhe që nuk është anëtar në jo më shumë se 2 (dy) komisione të përhershme.
3. Fleta e aplikimit për anëtar të komisionit të përhershëm të promovimit të personelit akademik në UMT gjendet bashkëlidhur këtij urdhri.
  4. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Sekretarinë e Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nga data 07.10.2019 deri më 23.10.2019.
  5. Ngarkohet njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë të njoftojnë personelin akademik përkatës si dhe të publikojnë këtë urdhër në faqet e tyre zyrtare te internetit.
  6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**REKTORI**  
**ARBEN GJATA**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019

**FLETË APLIKIMI**

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË PROMOVIMIT TË  
PERSONELIT AKADEMIK NË UMT**

Në zbatim të nenit 46 i ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh”, të nenit 32, 33 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 2459/1 Prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

Unë, i nënshkruari/ e nënshkruara \_\_\_\_\_ paraqes kandidaturën time për për anëtar/e në Komisionin e Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të këtij komisioni, të shpallur me Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2019 “Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionit që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar...”.

Emër/ Atësi/ Mbiemër: \_\_\_\_\_

Datëlindja: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Gjinia: \_\_\_\_\_

Në zbatim të nenit 32 pika 5 e Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, deklaroj se nuk jam anëtar në më shumë se dy komisione të përhershme në UMT; deklaroj që nuk jam në ndjekje penale dhe i/e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale; deklaroj se ndaj meje nuk është marrë masë e sigurimit personal; deklaroj se nuk kam shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”; deklaroj se ndaj meje nuk ka masë disiplinore.

Bashkëlidhur:

- Kopje e dokumentit të identifikimit.
- Kopje e njëzuar me origjinalin e dëshmisë/ diplomës së titullit akademik “Profesor” ose vërtetim të lëshuar nga UMT-ja në mungesë të diplomës/dëshmisë.
- Formulari i deklaramit të gjendjes gjyqësore (bashkëlidhur).

**Aplikues**

\_\_\_\_\_  
Emër, Mbiemër, Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

*Kjo fletë aplikimi duhet të depozitohet në Sekretarinë e Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Mbiemri, emri	
Atësia/amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam  i/e padënuar  i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARUESIT

\_\_\_\_\_  
Emër, mbiemër/firmë

\_\_\_\_\_  
Emër, mbiemër/firmë/vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga \_\_\_\_\_

Subjekti i autorizuar

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

\_\_\_\_\_  
Data e nënshkrimit

**Shënim:** Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.